


551/26 10-02-2026



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 17 paragrafi 1 pika f) dhe p) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së”, nr.28/2008), nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.31/2008), Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.13/2012), Ligjit nr.05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.10/2015), Ligjit nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, nenit 8 paragrafi 1 pika gj) të Statutit të Komunës së Graçanicës (Nr.6320/15 i datës 22.10.2015), Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të rregullt të mbajtur më datën 10.02.2026, merr këtë:

VENDIM NR.02/2026/KG
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE
TË NDËRMARRJES PUBLIKE-KOMUNALE “EKOLOGJIA” SH.A. GRAÇANICË

Neni 1

Emërohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen publike-komunale “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me seli në Graçanicë.

Neni 2

Për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve emërohen personat e mëposhtëm:

1. Sasha Daniq (*Saša Danić*), anëtar (i emëruar nga kryetari i Komunës së Graçanicës),
2. Marija Steviq (*Marija Stević*), anëtare (e emëruar nga Kuvendi Komunal i Graçanicës),
3. Dejan Bozhidareviq (*Dejan Božidarević*), anëtar (i emëruar nga Kuvendi Komunal i Graçanicës).

Neni 3

Komisioni Komunal i Aksionarëve është i detyruar që, në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për shoqëritë tregtare, Statutin e NPK “Ekologjia”, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, të ushtrojë të drejtat dhe të ndërmarrë veprime në emër të Komunës së Graçanicës, si themeluese e Ndërmarrjes publike-komunale “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me seli në Graçanicë.

Neni 4

Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve i kryejnë detyrat e tyre pa kompensim.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi nr.07/2022/KG për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike-komunale “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë (Nr.380/22 i datës 04.02.2022).

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës



Milan Dimitrijević